

UDHËZIM
Nr. 24, datë 30.7.2018

**PËR PROCEDURAT PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN E MËSIMNXËNIES DHE
KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE TË NIVELEVE 2 DERI NË NIVELIN 5 TË
KORNIZËS SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE, PËRFSHIRË ATO TË PËRFTUARA
JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 7, germa “i” dhe nenit 21, pika 3, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”,

UDHËZOJ:

1. Njohjen e kualifikimeve profesionale të niveleve 2 deri në nivelin 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), që nënkuptojnë njohjen dhe njësimin e kualifikimeve profesionale të certifikuara jashtë vendit nga ofrues të AFP-së ose institucione të tjera të autorizuara nga kuadri ligjor i vendit përkatës për lëshimin e tyre.

2. Procedura për njohjen nënkupton kryerjen e aplikimit dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara në këtë udhëzim, për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve profesionale që u përkasin niveleve 2 deri 5 të KSHK-së, të lëshuara jashtë vendit nga institucione ofruese të AFP-së ose institucione të tjera të autorizuara nga kuadri ligjor i vendit përkatës për lëshimin e tyre.

3. Njohja dhe njësimi i kualifikimeve profesionale jashtë vendit ka për qëllim garantimin e të drejtës së personave për të vijuar arsimimin e formimin profesional, arsimin e lartë ose punësimin në vend.

4. Njohja e njësimi i certifikatave, diplomave ose titujve bëhet nga ministra përgjegjëse për AFP-në.

5. Dokumentet e certifikatave, diplomave ose titujve, për t’u njohur e njësuar duhet të plotësojnë njëkohësisht këto kushte e kriteret:

a) Të jenë lëshuar nga institucione jashtë vendit, të njohura/licencuara/akredituara të AFP-së ose institucione të tjera të autorizuara për të ofruar AFP-në;

b) Të jenë autentike;

c) Të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

6. Aplikimi për njohjen e njësimin e një certifikate, diplome ose titulli bëhet me anë të një kërkesë drejtuar ministrit përgjegjës për AFP-në, të cilës duhet t’i bashkëngjiten:

a) Kopje e noterizuar dhe e përkthyer e diplomës ose certifikatës që përfaqësojnë dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës;

b) Lista e notave dhe/ose suplementi;

c) Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj).

7. Dokumentet e dorëzuara për njohje nuk i kthehen më aplikantit.

8. Aplikimi nuk quhet i plotë nëse mungojnë pjesë të informacionit apo dokumenteve të cituara në pikën 6 të këtij udhëzimi. Procedura e njohjes vijon vetëm në rastet kur dokumentacioni i përcaktuar si i detyrueshëm për aplikim është i plotë. Informimi për plotësim dokumentacioni bëhet me e-mail ose postë të zakonshme. Procedura e njohjes, pas aplikimit vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Njësisë së AFP-së në ministrinë përgjegjëse për AFP-në. Njësia e AFP-së në ministrinë përgjegjëse për AFP-në kryen verifikimin e autenticitetit të dokumentit të certifikatës, diplomës apo titullit në rast se dokumenti i paraqitur nga aplikanti kërkuar nuk është i pajisur me Vulë Apostille apo legalizuar në formën e kërkuar për atë vend origjine. Në këtë rast kontaktohet institucioni që e ka lëshuar dokumentin të cilit mund t’i kërkohej edhe çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm në procesin e njohjes.

9. Njësia e AFP-së në ministrinë përgjegjëse për AFP-në, kërkon informacion edhe mbi statusin e institucioneve që e kanë lëshuar dokumentin që kërkohej të njësohet, vlefshmërinë e atij dokumenti dhe çdo informacion tjetër që konsiderohet i nevojshëm për njohjen.

10. Informacionet e mbërritura në formë shkresore, si edhe materialet e printuara të informacioneve të mbërritura në rrugë elektronike bëhen pjesë e dosjes së aplikantit.

11. Për njohjen dhe njësimin e certifikatave, diplomave e titujve të lëshuara në përfundim të kualifikimeve profesionale që i përkasin nivelit 2–5 të KSHK-së, ngrihet Komisioni i Njohjes nga ministri përgjegjës për AFP-në, i cili drejtohet nga drejtuesi i drejtorisë së AFP-së dhe ka në përbërje 2 përfaqësues nga kjo drejtori dhe 1 nga AKAFPK.

12. Komisioni i Njohjes vlerëson, njeh dhe njëson, në bazë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas parimeve

dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë duke respektuar dhe parashikimet e kuadrit ligjor shqiptar në fuqi. Komisioni i Njohjes, pasi merr në shqyrtim informacionin e ndodhur në dosjen e aplikantit, merr vendim për njohjen e njësimit të një certifikate, diplome apo titulli ose refuzimin e kërkesës.

Komisioni i Njohjes merr vendimin për njohje dhe njësim ose mund të vendosë t'ia kthejë dosjen sektorit të AFP-së në Ministrinë përgjegjëse për AFP-në, për plotësime të nevojshme në dokumentacion, sipas këtij udhëzimi. Ky sektor në bazë të vendimit të Komisionit, përgatit vërtetimin e njohjes dhe njësimit, për çdo aplikant. Në çdo rast njoftohet aplikanti dhe në rast të refuzimit të kërkesës, i jepen edhe arsyet përkatëse.

13. Në rast të miratimit të kërkesës, vërtetimi i njohjes dhe i njësimit lëshohet nga Ministria përgjegjëse për AFP-në në përfundim të procedurës së njohjes, jo më vonë se një javë nga përfundimi i procedurës së njohjes. Vërtetimi i njohjes dhe njësimit nënshkruhet nga kryetari i Komisionit të Njohjes dhe Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për AFP-në.

Formati i vërtetimit të njohjes dhe njësimit, bashkëlidhur shtojca 1, përmban këto elemente:

- a) Emrin dhe mbiemrin e kandidatit;
- b) Institucionin e arsimit profesional që ka lëshuar diplomën/certifikatën;
- c) Shtetin përkatës;
- d) Kohëzgjatjen zyrtare të programit të studimit;
- e) Emërtimin e programit të studimit;
- f) Njësimin e certifikatës/diplomës në Republikën e Shqipërisë.

14. Procedura e njohjes e njësimit, pavarësisht rezultatit, nuk duhet të zgjasë më shumë se 3 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës së aplikantit.

15. Tarifa për njohjen dhe njësimit të certifikatave dhe diplomave që i përkasin nivelit 2 deri në 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, për çdo certifikatë/diplomë që kërkohet të njësohet, është 3,000 (tre mijë) lekë.

16. Ngarkohen njësia e AFP-së në ministrinë përgjegjëse për AFP-në, AKAFPK-ja për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCËS
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

SHTOJCA 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË

Komisioni i Njohjes së Diplomave/Certifikatave

Nr. _____ prot.

Tiranë, më____.____.201__

VËRTETIM NJOHJEJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së znj/z. _____(emër mbiemër), lëshuar nga _____ (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), _____(shteti), me program _____-vjeçar (kohëzgjatja e programit), në programin _____(emërtimi i programit të studimit).

Kjo diplomë/certifikatë njësohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
KRYETARI I KOMISIONIT

(emër mbiemër)
(nënshkrimi)
(nënshkrimi)

(emër mbiemër)

(Vula e institucionit)

Sbënim. Ky vërtetim njohjeje është i vlefshëm kur lëshohet i shoqëruar me diplomën/ certifikatën e buaj, dhe është i vlefshëm vetëm në Republikën e Shqipërisë.